



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA JUNIK – OPŠTINA JUNIK – MUNICIPALITY OF JUNIK

Kuvendi i Komunës

Nr. 002/05 /

Datë: 01.03. 2022

Bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, (LVL) Nr. 03/L-040, neni 12 paragrafi 12.2 pika d), Statutit të Komunës së Junikut (të datës 29.9.2010), neni 22 paragrafi 22.1 pika 4, Kuvendi Komunal në Junik në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë: 28.02.2022, mori këtë:

V E N D I M

për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi

- I. Me këtë vendim themelohet Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi në komunën e Junikut/ në tekstin e mëtejme KKSBB .
- II. KKSBB-ja përbehet nga: (neni 4 udhëzim administrativ nr. 27/2012 MPB – 03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi)
 1. Kryetari i Komunës (Kryesues);
 2. Komandanti i Stacionit të Policisë;
 3. Një përfaqësues i bashkësisë islame;
 4. Kryesuesi i Komitetit për Komunitete;
 5. Zyrtari për Barazi Gjinore;
 6. Drejtori i Drejtorisë për Arsimit;
 7. Kryetari i Këshillit të Prindërve të Arsimit të Komunës përkatëse;
 8. Një përfaqësues i FSK-së;
 9. Një përfaqësues i secilit Këshill Lokal për Siguri Publike;
 10. Kryesuesi i Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi;
 11. një përfaqësues nga Sektori i Emergjencave Civile Komunale;
 12. një përfaqësues i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim;
 13. një përfaqësues nga OJQ,
 14. një përfaqësues nga mediat lokale,
 15. një përfaqësues nga komuniteti i biznesit dhe
 16. një përfaqësues nga komuniteti i personave me aftësi të kufizuara.
- III. Detyrat dhe përgjegjësitë e KKSBB-së janë të rregulluara në nenin 6 të udhëzim administrativ nr. 27/2012 MPB – 03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi.
- IV. Kryesuesi i KKSBB-së është Kryetari i komunës së Junikut (neni 8 i U/ ANr.27 /2017 të MPB-se dhe Nr. 03/2012 të MAPL-së).

- V. Kryetari i Komunës së Junikut obligohet që me shkrim t'iu drejtohet subjekteve të përcaktuara në neni II të këtij Vendimi për dërgimin e përfaqësuesve të tyre.
- VI. Në bazë të propozimeve të komuniteteve përkatëse përgatit listën e anëtarëve të KKSBS-së duke përfshirë të gjithë akterët, ashtu siç është përcaktuar në nenin 4 të këtij udhëzimi administrativ dhe të njëjtën listë e dërgon në Kuvendin Komunal për miratim;
- VII. KKSBS-ja, në afat prej 30 ditëve nga konstituimi harton planin vjetor të punë dhe ia dërgon Kuvendit për miratim.
- VIII. KKSBS-ja, obligohet të informoj Kuvendin Komunal dy (2) herë brenda vitit për aktivitetet e KKSBS-së.
- IX. Anëtarët e KKSBS-së kanë mandat të njëjtë me anëtarët e Kuvendit të Komunës së Junikut.
- X. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhen zyrtare në ueb faqen zyrtare të Komunës së Junikut.

Me këtë vendim njoftohen:

- MAPL - MPB,
- Zyra e Kryetarit të Komunës,
- Arkiva.

Kryesuesi i Kuvendit
z. Shpejtim Gacaferi

